



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-084

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT 2005/20 PËR NDRYSHIMIN
E RREGULLORES SË UNMIK-ut 2001/35 PER FONDIN PENSIONAL TE KOSOVES**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 2005/20 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë ("Rregullorja"),

Duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar Rregulloren në mënyrë që arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentët tjerë relevantë,

Miraton këtë

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT 2005/20 PËR
NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut 2001/35 PER FONDIN
PENSIONAL TE KOSOVES**

Neni 1

Secilën herë që përmendet "Rregullorja" në Rregullore, ajo të zëvendësohet me fjalën "Ligji".
Secilën herë që përmendet "Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës - BPK" në Rregullore, ai të zëvendësohet me "Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK".

Neni 2

Teksti i tërë pjesës hyrëse të Rregullores të zëvendësohet me formulimin në vijim:

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke ditur se Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) funksionon si subjekt i pavarur juridik nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, e cila është organ i pavarur sipas nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton këtë

LIGJ PËR FONDIN PENSIONAL TE KOSOVES

Neni 3

Në nenin 1 të Rregullores, paragrafi i titulluar "BPK" do të zëvendësohet në tërësi me formulimin në vijim:

“BQK” do të thotë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që është përgjegjës si agjenci e pavarur sipas nenit 142 të Kushtetutës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve pensionale, siguruesve të pensioneve, drejtorëve të mjeteve dhe instrumenteve për investime të hapura si dhe mbajtësve sipas këtij Ligji dhe ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Neni 4

Në nenin 1 të Rregullores, paragrafi i titulluar "KEF" të fshihet në tërësi.

Neni 5

Në nenin 1 të Rregullores, paragrafi i titulluar "PSSP" të fshihet në tërësi.

Neni 6

Neni 2.2 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 2.2 në vijim:

2.2 Vendosija e politikës ekonomike lidhur me pensionet si pjesë e politikës buxhetore dhe fiskale është përgjegjësi e Qeverisë. Qeveria e realizon këtë politikë përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Guvernatori i BQK-së, dhe anëtarë të tjerë të emëruar nga Kryeministri do të përbëjnë grupin punues ndërministror për politikën e pensioneve. Grupi punues për politikën e pensioneve sipas nevojës propozon rregulla dhe rregullore të nevojshme për zbatimin e politikës pensionale dhe i bën rekomandime Qeverisë lidhur me fondin e kursimeve pensionale, lejimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e pensioneve në Kosovë.

Neni 7

Në nenin 4.1 të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me fjalën "Kuvendi", dhe të fshihet shprehja "dhe të miratuar nga PSSP-ja."

Neni 8

Në nenin 4.2 të Rregullores, të fshihet shprehja "institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes".

Neni 9

Neni 5.1 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.1 në vijim:

5.1 Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (më tej "Fondi") është person i pavarur juridik nën mbikëqyrjen e BQK-së, i themeluar me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime, në investim të kujdesshëm dhe në ruajtjen e mjeteve pensionale dhe pagimin e të ardhurave që krijohen në llogaritë individuale për blerjen e pensioneve vjetore, për pensionet e bazuara në kursime, si një administrues i besuar që vepron në emër të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

Neni 10

Në nenin 5.3 të Rregullores, shprehja Bord Drejtues të vihet nën thonjëza.

Neni 11

Neni 5.5 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.5 në vijim:

5.5 Së paku një (1) nga anëtarët e këshillit drejtues duhet të ketë përvojë profesionale për përfaqësimin ose këshillimin e punëdhënësve në Kosovë. Së paku një (1) nga anëtarët e këshillit drejtues duhet të ketë përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë. Një zyrtar i Qeverisë emërohet nga Kryeministri si anëtar pa të drejtë vote për të përfaqësuar Qeverinë në bordin drejtues.

Neni 12

Neni 5.6 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.6 në vijim:

5.6 Një komision për përzgjedhje i propozon kandidatë Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim apo për riemërim të anëtarëve të bordit drejtues. Komisioni për përzgjedhje guvernatorin e BQK-së (kryesues), auditorin e përgjithshëm dhe sekretarin e përhershëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në këshillin drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes. Pas skadimit të mandatit të anëtarëve ekzistues ndërkombëtar në Bordin Drejtues dhe deri në përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjes e Statusit të Kosovës, të datës 26 Mars 2007, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do ta emërojë një përfaqësues ndërkombëtar si anëtar të Bordit Drejtues.

Neni 13

Në nenin 5.7 të Rregullores, shprehja "UNMIK" të zëvendësohet me fjalën "Qeverisë".

Neni 14

Neni 5.11 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.11 në vijim:

5.11 Kuvendi emëron anëtarin (ët) e bordit drejtues, duke përfshirë edhe kryesuesin, bazuar në rekomandimet e komisionit për përzgjedhje, pas konsultimit me Qeverinë. Qeveria i'a dorëzon opinionin e saj Kuvendit brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së Kuvendit për konsultim.

Neni 15

Në nenin 5.12 të Rregullores, shprehjet "PSSP" dhe "UNMIK" të zëvendësohen me fjalët "Kuvendi" dhe "Qeverisë" respektivisht.

Neni 16

Neni 5.15 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.15 në vijim:

5.15 Kryesuesi e drejton përgatitjen e buxhetit vjetor të Fondit, duke përfshirë shpenzimet dhe të ardhurat, siç janë taksat dhe transferimet nga të ardhurat e përgjithshme dhe ato ia paraqet Bordit Drejtues për miratim.

Neni 17

Në nenin 5.16 të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me shprehjen "BQK".

Neni 18

Neni 5.17 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.17 në vijim:

5.17 Aktivitetet e Fondit në përputhje me këtë Ligj do të financohen përmes pagesave të arsyeshme të bazuara në shpenzimet e llogarive individuale, siç është përcaktuar në nenin 8 dhe përmes transferimeve të tjera që kohë pas kohe mund t'i përcaktojë BQK-ja dhe siç pasqyrohet në buxhetin vjetor të Fondit që e ka miratuar Bordi Drejtues.

Neni 19

Në nenet 6.2 (j) dhe 6.2 (k) të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me fjalët "Bordi Drejtues" dhe "Kuvendi" respektivisht.

Neni 20

Në nenin 6.3 të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me fjalën "Kuvendit".

Neni 21

Në nenit 7.4 të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me shprehjen "Qeverisë pas konsultimit me BQK-në".

Neni 22

Në nenin 10.11 (g) të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me shprehjen " BQK-ja në konsultim me Qeverinë".

Neni 23

Në nenet 34.1 (f) dhe 34.1 (g) të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me fjalën "Kuvendit".

Neni 24

Neni 34.2 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 34.2 në vijim

34.2 Nëse BQK-ja konstaton se ekziston rrezik i madh nga humbja e menjëhershme e një pjese të madhe të mjeteve të fondit pensional, që tejkalon dhjetë për qind (10%) të shumës së përgjithshme të mjeteve në mënyrë që të krijojë një gjendje të mundshme emergjente, BQK-ja menjëherë mund të ndërmer veprimet e parapara në nenin 34.1 (a), (b), (c), (d) ose (e) lart për të parandaluar humbjen e mjeteve të fondit pensional. Veprimi i tillë duhet kufizuar në 30 ditë gjatë së cilës BQK-ja duhet të njoftojë Kuvendin dhe Qeverinë me shkrim mbi natyrën e emergjencës, duke i dërguar një kopje fondit dhe të bëjë përpjekje që çështjen ta zgjidhë me fondin. Në fund të periudhës 30-ditore, për çdo veprim të vazhduar me qëllim të përmirësimit të gjendjes do të kërkohet marrëveshje me shkrim nga Qeveria. Nëse Qeveria nuk e konfirmon veprimin e ndërmarrë nga BQK-ja, ai veprim ndërpritet pas 30 ditësh.

Neni 25

Neni 34.3 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 34.3 në vijim:

34.3 Nëse BQK-ja konstaton se ka shkelje të këtij Ligji apo të rregullave të BQK-së, por nuk ka rrezik nga humbja e menjëhershme e një pjese të madhe të mjeteve të fondit pensional që kalojnë dhjetë (10%) për qind mund të ndërmer veprime ndaj fondit vetëm pasi arsyet për veprimin e ndërmarrë t'i paraqiten me shkrim fondit, Qeverisë dhe Kuvendit, dhe pasi fondit t'i jepet mundësia të kundërshtojë dhe të sqarojë çështjen brenda 30 ditësh. Nëse pas përgjigjes së fondit ka mosmarrëveshje ndërmjet BQK-së dhe fondit, BQK-ja mund të vendosë që të veprojnë lidhur me këtë çështje, sipas nevojës, për korigjimin e shkeljes së këtij ligji ose cilëndo nga rregullat e BQK-së. Fondi mund të kërkojë shqyrtimin e këtij veprimi para gjykatës kompetente.

Neni 26

Në nenin 36.3 të Rregullores, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me shprehjen "Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës"

Neni 27

Neni 38 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 38 në vijim:

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës mund të nxjerrë Urdhëresa Administrative për zbatimin e këtij Ligji.

Neni 28

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-084
13 qershor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI